

## PROF. MENELLA S. KARAJANI

(1912 – 1998)

### PRIFTI M.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë

Menella KARAJANI u lind më 5 Maj të vitit 1912 në fshatin Labovë e Zhapës të rrethit të Gjirokastrës. Kur Menella ishte 2 vjeç, i ati Spiro Karajani me profesionin mjek, e vendosi familjen në qytetin e Gjirokastrës ku ai punonte. Në këtë qytet Menella kaloi fëmërinë dhe mori mësimet e para të cilat i kreu gjatë viteve 1918 – 1928. Më pas ai mësoi në liceun francez të Korçës (në vitet 1928 – 1932), të cilin e përfundoi me rezultate të larta. Falë kësaj fitoi një gjysmë burse për studime universitare në Francë.

Për liceun e Korçës, Prof. Karajani ruante respekt të jashtëzakonshëm, si për sa i përket nivelit të lartë të mësimdhënies nga profesorët francezë e shqiptarë, ashtu dhe për rigorozitet e theksuar në drejtim të vlerësimit të dijeve të nxënësve. Në një rast, kujtonte Profesori, – nga ana e Drejtorit francez të Liceut u hodh dyshim për notën e lartë me të cilën, profesori shqiptar i letërsisë, kishte vlerësuar hartimin e një nxënësi. Po kur ai e lexoi hartimin u bind për vlerësimin tepër rigoroz të bërë nga profesori shqiptar. Atëherë ky i fundit, i ndërjegjshëm për të drejtën e tij, shprehej: – *Quand Je dis: dix huit sur vingt, c'est dix huit sur vingt* (Kur unë them tetëmbëdhjetë të njëzetat është tetëmbëdhjetë të njëzetat). Këtë ndodhi Profesori e kujtonte shpesh kur binte fjala për rigorozitetin që duhet treguar në vlerësimin e dijeve dhe për kujdesin që duhet bërë nga ana e mësuesve dhe pedagogëve që në fillim të karrierës së tyre për shpalsjen e këtij rigoroziteti në mënyrë që nxënësit të përkushtoheshin sa më seriozisht në përgatitjen e



tyre. Mësimet e Liceut por dhe karakteri i tij i fortë i vlejtnë Menella Karajanit në studimet e tij të mëtejshme por sidomos në punën e tij mësimore – shkencore të kryer për një periudhë 50-vjeçare.

Në vitet 1932–1935, Menella kreu studimet në Universitetin e Montpellier (Montpellier), ku fitoi një “Licence” në shkencat fiziko–kimike dhe paralelisht diplomën “Inxhinier Kimist”. Për rezultate të larta në diplomimin e fundit, iu akordua një çmim i posaçëm. Nga koha e studimeve, Profesori kujtonte shpesh mënyrën e shpjegimit, sidomos të Kimisë Inorganike, nga profesori francez i kësaj lënde. Për ta bërë shpjegimin sa më tërheqës, kur ai fliste për një nga grupet e sistemit periodik, p.sh. për grupin VII, në një leksion, ilustrimin e analogjive dhe diferencave e bënte duke shqyrtuar një element përfaqësues të grupit, p.sh. klorin, kurse në ciklin tjetër të leksioneve i drejtohej bromit. Menella student ishte i befasuar nga erudicioni i jashtëzakonshëm i disa prej profesorëve, të cilët njihnin mirë jo vetëm shkencat kimike por dhe të ngjashme me to, ndër të cilat veçanërisht fizikën.

Pas studimeve, në verën e vitit 1935, Menella Karajani u kthye në atdhe dhe në vjeshtën e atij viti u emërua pedagog i kimisë dhe i fizikës në Gjimnazin e Shtetit në Tiranë. Që në fillim të karrierës së tij si arsimtar ai u prezantua si pedagog i aftë dhe tepër rigoroz në vlerësimin e dijeve të nxënësve. Për këtë ai fitoi respektin e kolegëve dhe të nxënësve, por jo të sundimtarëve. Një notë negative për një nga nipat e mbretit, bëri që ai në tetor të vitit 1938 të transferohej në Shkollën Teknike. Një vit më vonë kjo shkollë kaloi në qytetin e Korçës dhe aty u vendos edhe mësuesi i ri. Me pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste, Menella u cilësua si “një ndër kundërshtarët më të vendosur të afirmimit italian në Shqipëri”. Për këtë në janar të vitit 1940 u arrestua dhe u internua në Pesaro të Italisë, ku qëndroi për gati dy vjet. Nga koha e internimit, pas shumë vitesh, Profesori kujtonte udhëtimet nëpër Itali dhe vizitat e bëra në qytetet kryesore të vendit.

Në tetor të vitit 1941, Menella lirohet nga internimi, kthehet në atdhe dhe emërohet përsëri pedagog në Gjimnazin e Tiranës, ku punon deri në tetor të vitit 1947. Gjatë kohës së luftës ai nuk rreshti së ndihmuari materialisht dhe moralisht forcat antifashiste, duke mbajtur lidhje të ngushta me disa nga nxënësit e tij më të mirë që ishin dhe pjesëmarrës të luftës antifashiste çlirimtare.

Në tetor të vitit 1947 u hap në Tiranë Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i cili më pas u shndërrua në Institut 4-vjeçar. Menella Karajani u emërua që në fillim pedagog i Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike, kurse në vitet 1955 – 1957 ka pasur dhe detyrën e Dekanit të Institutit. Në këto vite (1950–1956) Prof. Karajani, krahas punës pedagogjike, hartoi dhe tekstin e parë: Kimia për

klasën VII, i cili u ribotua dy herë dhe shërbeu për shumë vite si teksti fillestar i Kimisë për nxënësit shqiptarë.

Në vitin 1957 u hap Universiteti i Tiranës. Menella Karajani një nga pedagogët më me përvojë në fushën e kimisë u emërua përgjegjëse e Katedrës së Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, detyrë të cilën e kreu me nder dhe përkushtim deri në vitin 1983.

Gjatë punës së tij të palodhur në zhvillimin e leksioneve dhe drejtimin e praktikave laboratorike të Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike, Prof. Karajani mësoi dhe edukoi breza të tërë kimistësh, të cilët punuan në çdo cep të Shqipërisë dhe shumë prej tyre vazhdojnë të punojnë në ditët tona.

Në rrafshin didaktik, Profesor Karajani ishte padyshim ndër pedagogët më të shquar të kimisë. Me karakterin e tij tepër kërkues ai i vinte studentët në pozita pune. Vlerësimi i studentëve prej tij në provim, ishte më i miri që bëhej ndër të gjithë pedagogët e kohës. Të gjithë e pranonin këtë vlerësim si studentët e mirë ashtu dhe të më dobët.

Në fund të viteve 60-të dhe në vitet e para 70-të në Universitet u vu detyrë që të përgatiteshin tekste për të gjitha lëndët. Për tekstet e Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike, në krye të punës ishte Prof. Karajani. Bashkë me kolegët ai arriti të përgatisë një varg tekstesh me përmbajtje shkencore dhe didaktike për t'u admiruar. Përmendim këtu tekstin e Kimisë së Përgjithshme për degën e Kimisë me katër vëllime që u përdor nga studentët e Kimisë për një periudhë gati 25-vjeçare.

Prof. Karajani përveç punës së palodhur në fushën e mësimdhënies u përkushtua me një pasion të jashtëzakonshëm në kërkimin shkencor, pikërisht në drejtim të pasurimit të fosforiteve të zonës së Gjirokastrës, për t'i përdorur më pas si lëndë të parë për prodhimin e superfosfatit, prodhim ky që ishte planifikuar të bëhej në Laç. Edhe pse nuk u arrit që Uzina e Superfosfatit të punojë me lëndën e parë të vendit, puna shkencore e drejtuar nga Prof. Karajani, u krye me një nivel të mirë për kohën. Sektori shkencor i ngritur pranë Katedrës së Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike dhe i drejtuar nga Prof. Karajani, numëronte disa kuadro të larta dhe të mesme. Ky Sektor u bë pararoja e kërkimit shkencor në Universitetin e Tiranës. Ai, për disa mostra përfaqësuese, arriti në rezultate mjaft pozitive në drejtim të pasurimit të tyre. Këto rezultate janë publikuar në artikuj shkencorë dhe në disa referime të bëra në sesione shkencore. Duke u angazhuar vetë dhe duke drejtuar vartësit, me gjithë vështirësitë e njohura, Prof. Karajani, arriti të vendosë një disiplinë shkencore të admirueshme. Një meritë të padiskutueshme Prof. Karajani ka edhe për hapjen e një fushe të re të kërkimit shkencor në Katedër. Kjo u bë e

mundur në mesin e viteve 70-të. Është fjala për fushën e 'Korrozionit të metaleve dhe të mbrojtjes prej tij'. Prej më shumë se 30 vjetësh në Seksionin e Kimisë së Përgjithshme dhe Inorganike puna kërkimore është e organizuar në këtë fushë. Janë mbrojtur disa teza për gradën Doktor dhe mikroteza për Master, janë bërë referime dhe janë botuar shumë artikuj shkencorë, si dhe janë bërë disa zbatime të rezultateve kërkimore në degë të ndryshme të industrisë.

Në janar të vitit 1983, Prof. Karajani u lirua nga detyra e përgjegjësit të Katedrës, kurse në janar të vitit 1985, pas 50 vjet pune të palodhur, të kryer me nder e përkushtim, gjithmonë i udhëhequr nga parime të larta morale dhe njerëzore, në moshën 73-vjeçare, u tërhoq në pension, i respektuar dhe i nderuar nga të gjithë.

Një jetë e tërë në punë, një jetë e tërë në aktivitet, lodhje, shqetësime, por edhe kënaqësi të herëpashershme. Për merita në punë, për kontribut të padiskutueshëm në përgatitjen e specialistëve kimistë, mësues e teknologë, për rezultatet në punën kërkimore-shkencore, Prof. Menella Karajani i janë dhënë urdhra dhe medalje të ndryshme. Ai është nderuar me çmimin e parë të Republikës dhe me titullin e lartë Profesor. Prof. Karajani është karakterizuar gjatë gjithë jetës së tij nga ndershmëria, përkushtimi në profesionin e pedagogut dhe kërkesa e lartë në kontrollin e dijeve të nxënësve dhe studentëve. Për të gjitha këto virtyte të larta të këtij personaliteti të shquar të arsimit tonë mund të themi të sigurt se ai mbetet një pasuri kombëtare në Panteonin e Dijes dhe të Arsimit shqiptar.